



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Këshilli Drejtues

V E N D I M

Nr.2604, datë 24.08.2015

Për

Heqjen e të drejtës së ofrimit të shërbimeve dhe të rrjeteve të komunikimeve elektronike si dhe çregjistrimin nga regjistri i sipërmarrësve të sipërmarrësit Xheni AD sh.p.k.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj.Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj.Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj.Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 24.08.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Heqjen e të drejtës së ofrimit të shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike si dhe çregjistrimin nga regjistri i sipërmarrësve të sipërmarrësit Xheni AD sh.p.k.

BAZA LIGJORE:

- Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (ligji nr. 8485), i ndryshuar;
- Neni 54, Neni 98 dhe Neni 135, pika 2, paragrafi a) dhe b) të Ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918), i ndryshuar;
- Rregullore “Për Autorizimin e Përgjithshëm” Nr. 24 datë 02.02.2012 miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1774, datë 02.02.2012, ndryshuar me VKD të AKEP Nr.2429 datë 13.03.2014 dhe VKD Nr.2443 datë 10.04.2014;

- Urdhëri nr. 1390 Prot., datë 22.01.2015, “Për procedurën e inspektimit në distancë, administrimin e informacionit të përfutur dhe planifikimit të tematikës së inspektimit dhe monitorimit”.

K Ë SH I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa me nr.790/1 prot. datë 08.04.2015 me lëndë: Mbi publikimin e informacionit për tarifata si dhe Kushtet e Aksesit dhe përdorimit të faqes elektronike “web”, drejtuar sipërmarrësve që nuk e kishin realizuar një detyrim të tillë.
2. Korespondenca me email të datës 04.03.2015, me sipërmarrësit që nuk kishin përmbushur detyrimet sipas shkresave të mësipërme.
3. Relacioni shpjegues mbi Projekt-Vendimin(**Relacion**), si dhe

duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazën ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N

1. Me Urdhrin nr. 1390 Prot., datë 22.01.2015, “Për procedurën e inspektimit në distancë, administrimin e informacionit të përfutur dhe planifikimit të tematikës së inspektimit dhe monitorimit”, është udhëruar kryerja e Inspektimit në distancë për sipërmarrësin e komunikimeve elektronike **Xheni AD sh.p.k.**, me objekt verifikimin e zbatimit të:
 - Kushteve të përcaktuara në Autorizimin e përgjithshëm lidhur me:
 - *Bashkëveprimin e shërbimeve dhe interkoneksionin e rrjeteve;*
 - *Sigurimin e disponueshmërisë dhe përdorimin e numrave nga plani i numeracionit për përdoruesit fundorë;*
 - *Mbrojtjen e të dhënave vetjake dhe të privatësisë;*
 - *Mbrojtjen e përdoruesve;*
 - *Respektimin e rasteve të kufizimeve në lidhje me përmbajtjen e paligjshme ose të dëmshme;*
 - *Lejimin e përgjimit nga autoritetet kompetente;*
 - *Ofrimin e rrjeteve të komunikimeve publike në rastet e gjendjes së emergjencës;*
 - *Detyrimi për të ofruar akses;*
 - *Mbrojtjen e rrjeteve të komunikimeve publike ndaj aksesit të paautorizuar;*
 - *Detyrimin për të plotësuar standardet dhe specifikimet teknike të rrjeteve dhe të pajisjeve për ndërtimin e rrjeteve dhe ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike si dhe të shërbimeve të faciliteteve shoqëruese;*
 - *Regjistrimin e pajtimtarëve, ruajtjen dhe administrimin e të dhënave për qëllime të ndjekjes penale, etj;*
 - Kushteve të përcaktuara në Autorizimin Individual për përdorimin e frekuencave;
 - Kushteve të përcaktuara në aktet normative të AKEP lidhur me:
 - *Publikimin e informacionit për tarifata si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve;*

- *Kushteve të përgjithshme të kontratave tip me pajtimtarin.*

I. Në zbatim të urdhrimit të lartpërmendur, i është përcjellë sipërmarrësit **Xheni AD sh.p.k.** :

1. Shkresa nr.790/1 datë 08.04.2015 mbi Publikimin e Informacionit për Tarifatat si dhe Kushtet e Aksesit dhe përdorimit të faqes elektronike “web”;
2. Korespondenca me email i datës 04.03.2015 për publikimin e informacionit për tarifatat si dhe Kushtet e Aksesit dhe përdorimit të faqes elektronike “web”,

II. Në përfundim të verifikimit të zbatimit të detyrimeve të sipërmarrësit, dhe duke patur parasysh dokumentacionin e dorëzuar në AKEP në zbatim të rregullores dhe ligjit nr. 9918, i ndryshuar, konstatohet se:

1. Sipërmarrësi **Xheni AD sh.p.k.**, sipas Autorizimit **Nr. 2012-AP-U203-8-1**, datë 10/05/2012 është regjistruar për të ofruar:

- A. *Rrjete publike të komunikimeve elektronike:*
 - *Rrjete publike tokësore fikse aksesi dhe transmetimi*
- B. *Shërbimeve publike të komunikimeve elektronike:*
 - *Shërbime telefonike / Aksesi në internet etj.*

2. Pas verifikimit, rezulton se, sipërmarrësi **Xheni AD sh.p.k.:**

1. Nuk ka Faqe web-i të ndërtuar e rrjedhimisht pa informacione të publikuara.

Bazuar në:

- Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
- Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1774, datë 02.02.2012, ndryshuar me VKD të AKEP Nr.2429 datë 13.03.2014 dhe VKD Nr.2443 datë 10.04.2014;
- Rregulloren nr. 27, datë 21.9.2012 “Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve”

dhe në zbatim të nenit 135, pika 2, e ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, i ndryshuar, i propozohet Këshillit Drejtues të AKEP, heqjen e së drejtës së ofrimit të shërbimeve dhe të rrjeteve të komunikimeve elektronike si dhe çregjistrimin e sipërmarrësit **Xheni AD sh.p.k.**, nga regjistri i sipërmarrësve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, në pikën 1 të nenit 115 dhe pikën 3 / b të nenit 135, të ligjit nr. 9918/2008 të ndryshuar, dhe në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S:

1. Të miratojë heqjen e së drejtës së ofrimit të shërbimeve dhe të rrjeteve të komunikimeve elektronike si dhe çregjistrimin nga regjistri i sipërmarrësve të sipërmarrësit **Xheni AD sh.p.k.**
2. Të njoftohet sipërmarrësi **Xheni AD sh.p.k.**, për zbatimin e këtij Vendimi;
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Tiranës, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij vendimi.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.
5. Efektet e këtij vendimi fillojnë 60 dite pas njoftimit të këtij Vendimi Sipërmarrësit **Xheni AD sh.p.k.**

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____